



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 068/8
Prishtinë, më 14 maj 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 14, 15, 22, 27 DHE 28 MAJ 2009

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup Krasniqi**, kurse e ndihmoi anëtari i Kryesisë së Kuvendit, zoti **Ibrahim Gashi**.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 70 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetari propozoi që pika e dhjetë e rendit të ditës të shqyrtohet si pikë e tretë e rendit të ditës. Kuvendi e miratoi këtë propozim me vota të hapura.

Në fillim të seancës, deputeti **Numan Baliç**, kërkoi sqarime lidhur me kërkesën e 6 deputetëve për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të

drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, për t'u shqyrtuar në seancë plenare.

Kryesuesi konstatoi se kërkesa e lartpërmendur është në procedurë, Komisioni përkatës funksional duhet të bëjë Raportin me rekomandime, në mënyrë që pastaj të hyjë në rend të ditës për seancë plenare.

Deputeti **Esat Brajshori**, kërkoi sqarime rreth propozimit për kandidatin për kryetar të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e Bordit Drejtues të RTK-së.

Kryesuesi konstatoi se një propozim i tillë ende nuk i ka arritur Kuvendit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur me 30 prill 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizimin,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet biocide,
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2008,
8. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008,
10. Informatë lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 26 mars 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 30 prill 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** parashtroi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me pagesën e punëtorëve të shëndetësisë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj-Bujupi.

Deputeti **Esat Brajshori** parashtroi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me pronën e ish RTP-së, pas vendimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me këtë pronë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Brajshori.

Deputetja **Zylfije Hundozi** parashtoi pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, **Sadri Ferati**, lidhur me masat e marra për monitorimin e shkeljes së të drejtave të njeriut, që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Kaqusha Jashari** parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, lidhur me mundësinë e rregullimit me ligj të moshës së profesorëve universitarë nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Jashari.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtoi pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, lidhur me pajisjen e prodhuesve të ndryshëm me leje mjedisore.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputetja **Drita Kadriu** parashtoi pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, **Sadri Ferati**, lidhur me aktivitetet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në komunën e Mitrovicës.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadriu.

Deputeti **Driton Tali** parashtoi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me masat e marra ndaj ministrave të cilët kishin emëruar këshilltarët politikë në vend të sekretarëve të përhershëm nëpër ministri.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Naser Rugova** parashtoi pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, **Arsim Bajrami**, lidhur me pagat e kandidatëve për zgjedhjet e kaluara dhe rregullimin e kësaj çështjeje për zgjedhjet e ardhshme lokale.

Ministri Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtoi pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, lidhur me pagesën e testit të maturës, nga 10 euro, nga ana e maturanëve.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja **Rita Hajzeraj-Beqaj** parashtoi pyetje për Kryeministrin **Hashim Thaçi** lidhur me ofertën për investitorët e huaj në Kosovë dhe çështjen e papunësisë për vitin 2009, në vend.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj-Beqaj.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashitroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, **Nenad Rashiç**, lidhur me arsyet e vonesës së Projektligjit të punës, për shqyrtim në Kuvend.

Ministri Rashiç iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

3. Informatë lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Hashim Rexhepi, tha se kriza globale aktuale duket se është më e thella nga 120 sosh sa kanë qenë deri më tani në botë. Kjo krizë ka përfshirë edhe tregun bankar, tregun e kapitalit, etj. Po duket se ekonomia e Kosovës do ta përballojë me sukses këtë krizë, falë edhe punës së mirë në sektorin financiar që po bën Qeveria e Kosovës.

Në vazhdim, tha se rënia e vlerës së kursimeve të Trustit ishte e pashmangshme, sepse Bordi i Trustit nuk ka mundur ta mbikëqyr një gjë të tillë pasi që mjetet financiare janë jashtë Kosovës. Ai konstatoi se për vitin 2008 humbjet në Trust janë për 29%, në krahasim me vitin 2007. Sa i përket vitit 2009, ai tha se në dy muajt e parë ka pasur një rënie të kursimeve të Trustit, kurse në majin mars dhe në fillim të prillit ka pasur lëvizje substanciale në kuptimin pozitiv, pra tregjet financiare kanë filluar të stabilizohen. Më tutje ai tha se veprimet e marra nga Banka Qendrore e Kosovës në raport me Trustin ishin në pajtim me ligjin dhe Bordit i kemi rekomanduar ndalimin e transferimit të mjeteve jashtë Kosovës.

Deputeti **Driton Tali**, në emër të grupit të deputetëve nënshkrues të mocionit, shprehu bindjen se nuk kanë marrë përgjigje të plota nga guvernatori në lidhje me atë çka kemi kërkuar.

Deputeti **Bahri Hyseni**, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, tha se kjo çështje ka qenë shqetësim i madh për të gjithë punëtorët që kanë kursyer mjete në këtë Trust. Në vend që këta njerëz të fitojnë nga djersa e tyre, kanë ndodhur humbje të mëdha. Shqetësim i Grupit Parlamentar të PDK-së është edhe fakti se deputetët para vetes është dashur të kenë një raport, e jo një informatë. Sidoqoftë, tha ai nëse kemi parasysh ecurinë e formimit të Trustit, i cili është bërë nga ish - PSSP-ja, kjo ndoshta edhe nuk ka mund të kalojë më mirë. Në fund, ai tha se pas fillimit të funksionimit të Bordit të ri, do të kërkojmë Raport të detajuar.

Deputeti **Naser Osmani**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së, tha se mjetet e grumbulluara të Trustit në fund të vitit 2008 kanë pësuar rënie për 34% dhe se Bordi ka mundur të parashikoj rënien me kohë, por ata nuk kanë vepruar me përgjegjësi të duhur. Humbjet e shkaktuara janë trajtuar si humbje kontabël e jo si humbje financiare. Ai në vazhdim theksoi se Banka Qendrore nuk ka bërë asgjë për t'a rritur vetëdijen që Bordi i menaxherëve e as Trusti të menaxhojnë më mirë me mjetet e Trustit. Në fund, ky deputet konstatoi se pasi nuk janë marrë veprimet e duhura, do të ishte mirë që për shkak të përgjegjësisë morale, të largohet Guvernatori nga ky post.

Deputetja **Myzejene Selmani**, nga Grupi Parlamentar i AKR-së, tha se informata e ofruar e guvernatorit është e zbehtë, në Trust kanë kursyer mjetet e veta 266 mijë punëtorë.

Ajo theksoi se në rastet kur humbjet janë 8%, atëherë guvernatorit i lejohet mundësia e veprimit të tij, pavarësisht mungesës së mandatit të Bordit dhe mungesës së Ligjit për pensionet.

Deputeti **Ardian Gjini**, nga Grupi Parlamentar i AAK-së, tha se është për keqardhje mungesa e ministrit të MEF-it. Interesat e qytetarëve të Kosovës janë mbi interesat e njerëzve përgjegjës në funksionet përkatëse. Në një situatë të tillë, theksoi ai, vota e Grupit Parlamentar që ai e përfaqëson, për guvernatorin është e reduktuar, për shkak se ai nuk ka marrë veprime për atë që është i obliguar të ndërmarrë.

Deputeti **Naser Rugova**, nga Grupi Parlamentar i LDD-së, tha se mungesa e përgjegjësve në Kuvend tregon seriozitetin e Qeverisë. Pas humbjeve të mëdha në Trust, neve na vjen një informatë e zbehtë në Kuvend. Parlamentit të Kosovës i dërgohet raport nga ata që ky parlament i ka emëruar. Në vazhdim, tha se para pak kohësh Qeveria ka theksuar se Kosova nuk preket nga kriza globale, kurse guvernatori është dashur ta alarmojë Qeverinë. Në fund, ai kërkoi që deputetët, por edhe Qeveria dhe guvernatori të sillen në mënyrë të përgjegjshme në relacion me këtë çështje.

Deputeti **Sadik Idriz**, nga Grupi Parlamentar “7+”, tha se agonia e pensionistëve në Kosovë sikur po vazhdon, por se tani përmes institucioneve të Kosovës. Do të duhej, tha ky deputet, që kur diskutohet kjo çështje, të jenë prezent në parlament ministri i Ekonomisë dhe i Financave dhe ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale. Në vazhdim, tha se Trusti nuk ka qenë transparent as ndaj Kuvendit të Kosovës, kurse Kuvendi ka të drejtë dhe është përgjegjës të kërkojë që mjetet e grumbulluara në Trust të përdoren për veprimtari të tjera.

Deputetja **Radmila Vujović**, nga Grupi Parlamentar SLS, tha se raporti që do të duhej bërë për Kuvendin dhe informata e dhënë, nuk janë të njëjta.

Deputetja **Vezira Emrush**, nga Grupi Parlamentar “Zajedno”, tha se jemi të brengosur me gjendjen aktuale në Trust, me humbjet e pensionistëve dhe me mos ndërmarrjen e masave të duhura në këtë drejtim. Një enigmë në Fondin Pensional po vazhdon, tha ajo, duke bërë në krahasim me gjendjen e Fondit Pensional para lufte në Kosovë. Në fund, deputetja konstatoi se ardhmëria e pensionistëve në Kosovë është shumë e pasigurt.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: **Naim Rrustemi, Fatmir Regjepi, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Emrush Xhemajli, Nait Hasani, Edita Tahiri, Riza Smaka, Ramadan Avdiu, Driton Tali, Mimoza Ahmeti, Myrvete Pantina, Gani Buçinca, Berim Ramosaj, Ahmet Isufi, Lulzim Zeneli, Xhevdet Neziraj, Rita Hajzeraj, Besa Gaxheri, Rrustem Mustafa, Arsim Regjepi, Ibrahim Gashi, Gani Geci dhe Adem Salihaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Standardizimin

Kryesuesi **Ibrahim Gashi** ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për Standardizimin.

Ministri **Lutfi Zharku**, tha se vitin e kaluar është miratuar Ligji për akreditimin, kurse ky projektligj synon të rritë nevojën e sigurisë së produkteve dhe të shërbimeve, heqjen e barrierave në tregun ndërkombëtar, si dhe të parametrave të tjerë nga kjo lëmi. Në vazhdim, tha se përmes këtij projektligji rregullohet funksioni i Këshillit profesional të standardizimit, si dhe synohet aderimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare të standardizimit. Ministri, në fund, theksoi se rëndësia e projektligjit qëndron në faktin se bëhet avancimi i Agjencisë për standarde. Ky Projektligj nuk e ngarkon buxhetin shtetëror. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë Projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për standardizimin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulëzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, **Kosara Nikoliç**, si dhe deputetët: **Fatmir Regjepi**, **Adem Hajdaraj** dhe **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për standardizimin.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Ministri **Valton Beqiri** tha se ky projektligj është pjesë e strategjisë legjislative për vitin 2009 dhe është hera e dytë që paraqitet para deputetëve për shqyrtim dhe miratim, në parim. Vërejtjet e paraqitura nga hera e parë, në këtë Projektligj janë inkorporuar. Në vazhdim, tha se ky projektligj riafirmon nxitjen dhe pjesëmarrjen e rinisë në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe është në përputhje me të gjitha orientimet për kompletim me infrastrukturë ligjore, për çështjet që kanë të bëjnë me rininë. Miratimi i këtij

Projektligji do të ishte në funksion të tërheqjes së donatorëve për investime në shumë fusha që ndërlidhen me problemet e rinisë në vend.

Ministri, në fund, konstatoi se projektligji është në harmoni me legjislacionin evropian dhe ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë Projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të komisionit funksional, **Agim Veliu**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Drita Kadriu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Anita Morina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kadaj-Bujupi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Drita Maliqi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Dragan Dimić**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Bahri Hyseni**, **Rita Hajzeraj**, **Njomza Emini**, **Sanije Aliaj**, **Naser Rugova**, **Fatmire Berisha**, **Riza Smaka**, **Hydajet Hyseni**, **Emrush Xhemajli**, **Gani Buçinca**, **Ardian Gjini** dhe **Nurishahe Hulaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,

Kundër-----0,

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryesuesi konstatoi se për shkak të mungesës së ministrit të Ekonomisë dhe të Financave apo të përfaqësuesit të Qeverisë për t’a paraqitur para deputetëve Projektligjin, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancë tjetër plenare.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet biocide

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ose raportuesin e komisionit, që ta marrë fjalën.

Elhame Hetemi, tha se komisioni funksional ka paraqitur amendamentet e veta dhe i ftoi deputetët që t'i votojnë ato.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për ta marrë fjalën, **Kryesuesi** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi amendamentin nr.1

Kryesuesi, para se të votohet amendamenti nr. 2, konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të votuar, pasi që në sallë ishin 58 deputetë të pranishëm.

Kryesuesi, **Ibrahim Gashi**, konstatoi se seanca plenare vazhdon punimet ditën e nesërme, me datë 15 maj 2009, në ora 10.

* * *

Vazhdimin e seancës plenare, më 15 maj 2009, e kryesoi zoti Ibrahim Gashi. Kryesuesi konstatoi se mungon kuorumi për vazhdimin e seancës sipas pikave të mbetura të rendit të ditës nga seanca e djeshme, andaj propozoi që seanca të shtyhet për 22 maj 2008.

Seanca plenare i vazhdoi punimet me datë 22 maj 2009 në orën 10.
Seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, kurse i ndihmoi Ibrahim Gashi.

Për fjalë u paraqit deputeti **Hajredin Hyseni**, i cili kërkoi që seanca e sotme të shtyhet për shkak të 10 vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës nga ana e regjimit okupues serb. Kërkesën e deputetit Hyseni e përkrahën shefat e grupeve parlamentare të: PDK-së **Ramë Buja**, të LDK-së **Lutfi Haziri**, të AKR-së **Ibrahim Makolli**, dhe të AAK-së **Ardian Gjini**.

Kryesuesi e hodhi në votim kërkesën e deputetit Hyseni dhe deputetë e votuan me ngritje të dorës.

Kryesuesi konstatoi se seanca vazhdon me datë 27 maj 2009, në orën 10.

Më 27 maj 2009, vazhdoi seanca plenare, në orën 10:13 minuta.
E kryesoi **Ibrahim Gashi**, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në ndërkohë, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare në mbledhjen e mbajtur me 19 maj 2009, vendosi t'i propozojë Kuvendit që në vazhdimin e seancës plenare më 27 maj 2009 të shqyrtojë edhe dy pika shtesë.

Kuvendi miratoi propozimin e kryesuesit.

Për fjalë u paraqit deputeti Fatmir Regjepi.

Fatmir Regjepi, tha se flet në emër të deputetëve nga Gjilani dhe të qeverisë komunale të Gjilanit, për stuhinë e breshërit që e kishte kapluar këtë komunë pak ditë më parë. Tha

se pas tërmetit të vitit 2002, kjo ishte fatkeqësia më e madhe natyrore që e kishte përfshirë këtë komunë. Vlerësimet preliminare flasin për një dëm të shkaktuar prej mbi 3 milionë euro, por besohet se janë më të mëdha. Ai tha gjithashtu se qeveria komunale e atjeshme nuk ka kapacitete, veçanërisht të natyrës financiare, që të ballafaqohet me këtë fatkeqësi dhe i ftoi donatorët e mundshëm, në veçanti Qeverinë e Kosovës, që të ndihmojnë në tejkalimin e kësaj gjendjeje.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet biocide

Kryesuesi, tha se amendamentin nr. 1 e kemi votuar me 14 maj 2009, kurse tani vazhdojmë me votimin prej amendamentit nr.2.

Deputetja **Elhame Hetemi**, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, kërkoi që neni 2 i Projektligjit të tërhiqet në tërësi.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetes Hetemi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër-----8,
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash aprovoi heqjen e nenit 2 nga Projektligji për produktet biocide.

Kryesuesi hodhi në votim një nga një amendamentet e tjera të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për produktet biocide.

2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2008

Kryesuesi, ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta marrë fjalën.

Myzejene Selmani, tha se ky Komision e ka miratuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2008. Ajo, ngrii edhe një çështje, atë të kontrollimit

të licencave. Është kërkesë e këtij Komisioni, tha ajo, që Qeveria të ribëjë emërimin e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, sa më shpejt që është e mundur. Ajo i ftoi në fund deputetët që ta miratojnë këtë Raport.

Gani Koci, foli në emër të Komisionit për Buxhet e Financa dhe tha se ky Raport i përmbush kriteret e raportimit, sipas Ligjit për financat publike. Çështjen që e ngriti deputetja Selmani, është në gjë që duhej të vlente edhe për bordet e tjera të agjencive të pavarura.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Regjepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Qamile Morina**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Arsim Regjepi**, **Myrvete Pantina**, **Sala Berisha**, **Naser Rugova**, **Emrush Xhemajli**, **Nait Hasani**, **Drita Kadriu**, **Berat Luzha**, **Gani Buçinca**, **Ramadan Avdiu** dhe **Ardian Gjini**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi hodhi në votim Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----42,
Kundër-----8,
Abstenime-----15.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2008.

3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që ta marrë fjalën.

Myzejene Selmani, tha se ky komision e ka miratuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008 dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e këtij raporti në seancë plenare.

Gani Koci, foli në emër të Komisionit për Buxhet e Financa dhe tha se ky raport i përmbush kriteret e raportimit, sipas Ligjit për financat publike. Kemi kërkuar nga

Qeveria që funksionimi dhe mënyra e financimit të të gjitha bordeve të rregullohet me ligj.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Heset Cakolli**, **Riza Smaka**, **Hajdin Abazi**, **Myrvete Pantina** dhe **Danush Ademi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----11,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2008.

4. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ta marrë fjalën.

Bahri Hyseni tha se ky Komision e ka miratuar Raportin e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008. Nga konstatimet në këtë komision del përfundimi se raporti është gjithëpërfshirës. Në vazhdim, tha se ky Agjencion është i ri dhe ka pasur edhe probleme të veta rreth konstituimit. Raporti në Kuvend është sjellë në afatin e paraparë ligjor. Një vërejtje që e përmendi ai është se, dy zyrtarë të Kuvendit, siç thuhet në Raport, nuk precizohet a janë deputetë apo zyrtarë të administratës së Kuvendit. Si komision kemi kërkuar që Ligji bazik të amendamentohet.

Në fund, tha se raporti është i mirë dhe ftoi deputetët që ta miratojnë.

Gani Koci foli në emër të Komisionit për Buxhet e Financa dhe tha se këtë raport e kemi shqyrtuar në komision, duke pasur parasysh disa vështirësi që e kanë përcjellë këtë Agjencion.

Kryesuesi hapi debat për Raportin e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së,

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobërdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Syla**, **Mark Krasniqi**, **Naim Rrustemi**, **Gani Geci**, **Kaqusha Jashari**, **Driton Tali**, **Ibrahim Makolli**, **Emrush Xhemajli**, **Gani Buqinca**, **Berim Ramosaj**, **Donika Kadaj-Bujupi**, **Bahri Hyseni** dhe **Lutfi Haziri**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim Raportin e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Raportin e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2008.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Ahmet Shala, tha se ky projektligj është i hartuar në frymën e reformave ekonomike. Në vazhdim tha se Qeveria është zotuar të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm fiskal dhe në pajtim me praktikat evropiane. Në këtë drejtim, e vetmja mënyrë është që të ndryshohet projektligji ekzistues për TVSH-në. Ndryshimet e bëra janë të lidhura me ciklin e investimeve të huaja, gjë që edhe për investitorët e huaj do të jetë më lehtë. Më tej, ai tha se ky projektligj i mundëson Administratës Tatimore të Kosovës që të harmonizohet më mirë me praktikat e reja konform direktivave evropiane nga kjo lëmi. Po ashtu, ministri potencoi çështjen e sugjerimeve dhe të inkorporimit të këtij fakti në projektligj, për heqjen e TVSH-së për pagimin e librit.

Ministri Shala në fund kërkoi nga deputetët miratimin, në parim, të Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Gani Koci foli në emër të Komisionit për Buxhet e Financa dhe tha se ky komision e mbështet miratimin në parim të këtij projektligji, bashkë me pakon e projektligjeve fiskale që do të vijnë më vonë.

Kryesuesi hapi debatin për Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Gjylnaze Syla**, **Myzejene Selmani** dhe **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 49,
Kundër-----11,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

6. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se në pajtim me nenin 23.2 d) të Ligjit për RTK-në, Kryesia e Kuvendit ka kërkuar që partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, të propozojnë nga një anëtarë në këtë komision.

Kryesuesi lexoi listën prej 20 kandidatëve të propozuar nga ana e partive politike.

Kryesuesi hapi debat për Formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanoviç**, si dhe deputetët: **Bahri Hyseni**, **Esat Brajshori** dhe **Ibrahim Makolli**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi, **Ibrahim Gashi**, para se ta hudhte në votim këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi se në sallë janë të pranishëm 39 deputet dhe nuk ka kuorum për të votuar.

Kryesuesi konstatoi se seanca ndërpret punimet për ditën e sotme dhe kjo pikë e rendit të ditës vazhdon më 28 maj 2009, në ora 10.

Kryesuesi e mbylli seancën në ora 18: 44 minuta.

E enjte, më 28 maj 2009

Seanca filloi në ora 10:15 minuta

Vazhdimi i pikës së rendit të ditës të ndërprerë nga seanca e mbajtur më 27 maj 2009, për Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Kryesuesi **Xhavit Haliti** tha se në mungesë të kuorumit për të votuar këtë pikë nga dita e djeshme, sot vazhdojmë me këtë pikë.

Kryesuesi hodhi në votim Formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----28,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

Seanca i përfundoi punimet në ora 10:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**